



INFORMACION PËR GRATË MBI NDARJEN LIGJORE DHE SHKURORËZIMIN:

NË MARTESE
NË BASHKËJETESE TË REGJISTRUAR
NË BASHKËJETESE

«Dua që të ndalet
dhuna dhe të
respektohem»

PËRMBAJTJA

Dua të ndahem. Si duhet të veproj?	3
Sa kushton një procedurë e ndarjes ligjore dhe kush e paguan avokaten?	3
Ç'mund të rregulloj me procedurën e ndarjes ligjore?	3
Kam frikë se situata do të marrë përmasa edhe më të rrezikshme, nëse ai merr vesh për ndarjen ligjore!	3
Po, nëse do të jetë e nevojshme që ndarja ligjore të bëhet shumë shpejt?	3
Kujt i takon banesa?	3
Tek kush do të jetojnë fëmijët?	3
Sa herë ka të drejtë burri im t'i takojë dhe të përkujdeset për fëmijët?	4
Me se të jetojmë?	4
A ndikon ndarja mbi statusin tim të qëndrimit	4
Ç'ndodh në seancën gjyqësore të ndarjes ligjore?	4
Ç'mund të ndër marr kundrejt një vendimi gjyqësor?	4
Mos është shkurorëzimi i menjëhershëm zgjidhje më e mirë?	4
Ç'mund të bëj, nëse kam qenë e detyruar të martohem kundër vullnetit tim?	5
Si duhet të veproj, nëse dua ta zgjidh bashkëjetesën e regjistruar?	5
Ne bashkëjetojmë pa lidhje ligjore (konkubinat) dhe unë dua të ndahem	5
Adresa të rëndësishme	5
Impressum	6

DUA TË NDAHËM. SI DUHET TË VEPROJ?

Ju mund të aplikoni në gjykatën e rrethit përkatës të vendbanimit tuaj (www.gerichte-zh.ch) për hapjen e një procedure ndarëse ligjore dhe të kërkonti të jetoni të ndarë (**formular i procedurës ligjore të ndarjes**). Hapjen e procedurës mund ta aplikoni vetë ose përmes një avokateje. Nëse keni mundësi merrni me vete në orën konsultuese në gjyq ose në bisedën e parë tek avokatja dokumentet si vijon:

- Dokumente për situatën tuaj financiare (dy deklarimet e fundit të tatimeve dhe faturat tatimore, borderonë e të ardhurave për 3 deri në 6 muajt e fundit, kupona për shpenzime të përsëritura, lëvizjet e llogarisë bankare për periudhën 3 deri në 6 muaj)
- Shënime/dokumente për ecurinë e martesës (të dhëna të rëndësishme dhe ngjarje, si p.sh. ushtrim të dhunës prej burrit, certifikata mjekësore, dokumente rreth procedurës penale, masave të mbrojtjes ndaj dhunës).

SA KUSHTON NJË PROCEDURË E NDARJES LIGJORE DHE KUSH E PAGUAN AVOKATEN?

Nëse keni vetëm pak para, atëherë ju ose avokatja juaj mund të shtroni një kërkesë për mbajtjen e procesit dhe zëvendësimin ligjor falas (**kërkesë**). Nëse kërkesa pranohet, shpenzimet e gjyqit dhe të avokates do të merren përsipër paraprakisht nga shteti. Nëse, në të ardhmen, do të dispononi më shumë para, atëherë gjykata ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve të gjyqit dhe të mbrojtjes brenda një hapësire kohore prej 10 vjetësh (**fletëpalosje**). Në rast se jeni në gjendje, që t'i paguani vetë shpenzimet e avokates, mund të informoheni mbi shpenzimet e procedurës ligjore të ndarjes tek një zyrë këshillimore ose tek një avokate.

Ç'MUND TË RREGULLOJ ME PROCEDURËN E NDARJES LIGJORE?

- Gjatë procedurës së ndarjes, gjyqtarja, ndër të tjera, zgjidh edhe pikat në vijim:
- Përcaktimin e banesës.
 - Përcaktimin e kujdestarisë për fëmijët.
 - Të drejtën për përkujdesje të prindit tjetër.
 - Shumën e kontributit për jetesë.
 - Ndarjen e pasurisë.

KAM FRIKË SE SITUATA DO TË MARRË PËRMASA EDHE MË TË RREZIKSHME, NËSE AI MERR VESH PËR NDARJEN LIGJORE!

Nëse burri juaj ushtron dhunë ndaj jush ose ndaj fëmijëve ose nëse ju kërcënon me dhunë, në një situatë akute, policia mund të ushtrorë masa mbrojtëse (**broshurë për masa mbrojtëse ndaj dhunës**). Ajo ka të drejtë të zbatojë masën e largimit të burrit tuaj nga shtëpia ose banesa, të zbatojë masë ndalimi për hyrje të tij në një lagje të caktuar, si dhe masë ndalimi të kontaktimit me ju dhe me fëmijën, për 14 ditë. Ju keni mundësinë, brenda 8 ditësh, ta zgjasni afatin e këtyre masave në mënyrë të papërsëritshme për 3 muaj (www.ist.zh.ch). Zyrat këshilluese për viktimat ju përkrahin dhe ju këshillojnë në lidhje me këtë kërkesë, falas dhe në besim. Zakonisht, këta tre muaj mjaftojnë që të arrini të bëni ndarjen. Nëse keni frikë se burri juaj do t'ju kërcënojë edhe pas skadimit të masave mbrojtëse edhe më tej, mund t'i drejtoni një kërkesë gjykatës së rrethit për ndalesë marrjeje kontakti ose masë ndalimi për hyrje në zonë (mbrojtje e personalitetit në përputhje me të drejtën civile KC 28 b [ZGB 28 b]). Këtë kërkesë mund ta dorëzoni njëkohësisht me kërkesën për të jetuar të ndarë. Kërkonti informacione rreth kësaj mundësie tek një avokate ose në zyrën tonë këshilluese. Strehimoret për gra ofrojnë një mbrojtje të plotë, nëse keni drojë se burri juaj nuk do t'i përmbahet masës së ndalimit për të mos ju kontaktuar (www.frauenhaus-schweiz.ch).

PO, NËSE DO TË JETË E NEVOJSHME QË NDARJA LIGJORE TË BËHET SHUMË SHPEJT?

Mund të kërkonti zbatimin e masave për mbrojtje superprovizore brenda procedurës së ndarjes ligjore. Për këtë duhet të jeni në gjendje, që të dëshmoni veprimet e dhunshme dhe urgjencën e kërkesës. Gjyqi, pastaj, do të zgjidhë përkohësisht- por shpejt, të njëjtat çështje, që rregullohen edhe në procedurën e ndarjes ligjore. Kërkesat që bëhen për marrjen e masave për mbrojtje superprovizore, janë shumë të larta. Nëse vendosni ta ndërmerri këtë hap, kontaktoni një zyrë këshilluese për viktimat ose një avokate.

KUJT I TAKON BANESA?

Personi, i cili ka më shumë nevojë për të - zakonisht ajo palë prindërore, e cila do të përkujdeset kryesisht për fëmijët, pas ndarjes. Shtroni kërkesat si në vijim, nëse doni të rrini edhe më tej në banesën familjare:

- Përcaktimin e afatit të largimit të partnerit (nga pak ditë deri në dy muaj). Nëse vëreni se burri nuk do ta lëshojë banesën vullnetarisht, kërkonti autorizimin për largimin e tij, në Entin e Ekzekutimit (Stadtammann-Amt).
- Kthimin e tufës së plotë të çelësave, që burri të mos ketë mundësi të hyjë, pa lejen tuaj, në shtëpi. Ndërroni drynin e banesës, nëse nuk jeni e sigurtë, se i keni marrë të gjithë çelësat, dhe ndiheni akoma e kërcënuar.

TEK KUSH DO TË JETOJNË FËMIJËT?

Tek prindi, i cili ka qenë deri në atë moment më shumë përgjegjës për përkujdesjen personale të fëmijëve, po dhe që është në gjendje ta garantojë edhe më tej atë. Gjyqtarja e kryen vetë vlerësimin, se ku ndihen fëmijët më mirë. Vëllezërit dhe motrat, zakonisht, qëndrojnë së bashku. Fëmijët mbi 6 vjeç mund të dëgjohen në gjyq, në kuadër të procedurës.

SA HERË KA TË DREJTË BURRI IM T'I TAKOJË DHE TË PËRKUJDESET PËR FËMIJËT?

Pala prindërore, që nuk gëzon të drejtën e kujdestarisë, ka të drejtë për takime personale me fëmijët. Mund të bëni një marrëveshje me burrin tuaj dhe të kërkonti për këtë miratimin e gjyqtarës. Nëse nuk jeni në një mendje, në shumicën e rasteve, e merr vendimin gjyqtarja si në vijim: për fëmijët e moshës së kopshtit: dy të shtuna ose të diela në muaj. Për fëmijët e moshës së shkollës: dy fundjava në muaj, si dhe dy javë pushim në vit. Bëni kujdes që të përcaktohen orare fikse të dorëzimit të fëmijëve dhe të keni një marrëveshje, edhe për ditët e festave, si pashkët, rrëshajat dhe krishtlindjet.

Nëse burri juaj i ka kërcënuar ose rrahur edhe fëmijët, si dhe, nëse gjatë dorëzimit të fëmijëve, ndodhin situata të dhunshme që përkeqësohen në mënyrë të përsëritur, mund të kërkonti një të drejtë vizite me shoqërim ose një asistencë ligjore. Një anulim i plotë i të drejtës për vizitë zbatohet vetëm në rastet e rreziqeve shumë të mëdha për fëmijët.

ME SE TË JETOJMË?

Mund të kalojnë javë apo muaj, derisa të paraqitet një akt-vendim për kontribut kompensues për jetesë. Aplikoni në mënyrë paraprake tek Shërbimi Social. Keni të drejtë të përfitonit përkrahje financiare nga shteti. Nëse keni një numër llogarie ose një kartë krediti të përbashkët me burrin tuaj, atëherë:

- Tërhiqni menjëherë, brenda mundësive, shumën e nevojshme të parave për tre muaj, nëse kontoja ose karta e kreditit janë të regjistruara në emrin e tij dhe nëse nuk keni para të mjaftueshme mënjane.
- Blllokoni menjëherë autorizimin e burrit mbi llogaritë ose kartat e kreditit, nëse ato janë të regjistruara në emrin tuaj.

Në kuadër të procedurës së ndarjes ligjore, llogaritet nevoja e të dyja buxheteve dhe kryhet tërheqja nga të ardhurat përkatëse të secilit. Mbi këtë bazë llogariten ushqimet për ju dhe

fëmijët tuaj. Nëse shpenzimet tuaja nuk mund t'i mbulonin me kontributet për jetesë dhe me të ardhurat tuaja, atëherë duhet t'i drejtoheni Shërbimit Social. Në varësi të situatës, ju keni të drejtë të përfitonit edhe nga kontributet e papunësisë.

Kontributet për jetesë të fëmijëve mund të jepen paraprakisht nga shteti, deri në shumën maksimale prej 940 frangash për çdo fëmijë. Kjo, fatkeqësisht, nuk vlen për sigurimin e jetesës së gruas. Zyra përmbartimore e komunës suaj, në emrin tuaj, ndjek ekzekutimin e detyrueshëm për dhënien e kontributeve.

A NDIKON NDARJA MBI STATUSIN TIM TË QËNDRIMIT

Shpeshherë, leja e qëndrimit në Zvicër është e lidhur me bashkëjetesën me burrin (leje e qëndrimit B). Lidhur me këtë ekzistojnë dallime nga qytetarët e ardhur nga shtete të BE-së, të cilat parimisht kanë kushte më të mira për vizitë dhe qëndrim të mëtejshëm në Zvicër. Për qytetarët, që nuk janë shtetas të BE-së, në rastin e ndarjes, ekziston mundësia për zgjatjen e qëndrimit, nëse martesë ka zgjatur së paku 3 vjet në Zvicër, dhe nëse kanë arritur të integrohen me sukses.

Por, mund edhe të paraqisni arsye të rëndësishme personale, veçanërisht nëse jeni bërë viktimë e dhunës familjare ose nëse riintegrimi në vendin e prejardhjes është shumë i rrezikshëm. Ruani, brenda mundësive, dëshmi të mundshme, si certifikata mjekësore, raporte të shtëpive strehimore për gra/zyrave këshilluese ose raportet e policisë. Statusi i lejes së qëndrimit tuaj, nuk duhet të jetë arsye, që të duroni dhunë familjare. Ne ju këshillojmë në këtë çështje falas dhe në besim të plotë.

Ç'NDODH NË SEANCËN GJYQËSORE TË NDARJES LIGJORE?

Informohuni për procedurën e zhvillimit të një seance gjyqësore të ndarjes ligjore pranë një zyre këshillimore, një avokateje ose në gjykatë.

Nëse keni shkuar në gjyq pa avokate:

- mos nënshkruani asnjë marrëveshje, për të cilën jeni e pasigurt ose

- nënshkruani, por me kushtin e së drejtës së kundërshtimit brenda 10 ditëve. Paraqitjani marrëveshjen një avokateje për vlerësim dhe kundërshtojeni atë, mundësisht, brenda afatit.

Nuk lejohet marrja e fëmijëve në seancën gjyqësore të ndarjes ligjore. Rezervoni një gjysmë dite për seancën dhe organizoni kujdestarinë e fëmijëve, në mënyrë të tillë, që mos t'u shkaktohet stres, në rast se seanca zgjatet. Kërkonti në kohë një përkthyes për seancën gjyqësore, në rast se gjermanishtja nuk është gjuha juaj amtare.

Ç'MUND TË NDËRMARR KUNDREJT NJË VENDIMI GJYQËSOR?

Nëse nuk pajtoheni me vendimin gjyqësor të ndarjes ligjore, duhet ta kërkonti atë të arsyetuar me shkrim, brenda 10 ditësh, ose të bëni apelim (shih: udhëzimet për ankesë në fundin e akt-vendimit). Pas afatit 10 ditor, për të shfrytëzuar apelimin, vendimi do të hyjë në fuqi të plotë dhe, në këtë rast, ju mund të kërkonti ndryshim vetëm në rastin kur situata ka ndryshuar thelbësisht.

Nëse jetoni sërish me burrin tuaj së bashku, atëherë, pas përafërsisht 3 deri 5 javësh, vendimi e humbet automatikisht vlerën.

MOS ËSHTË SHKURORËZIMI I MENJËHERSHËM ZGJIDHJE MË E MIRË?

Shkurorëzimi mund të kryhet në çdo çast, nëse të dyja palët pajtohen me këtë dhe e konfirmojnë, para gjykatës së rrethit, vullnetin e tyre për t'u shkurorëzuar. Përvoja na mëson, që shpeshherë ndodh që ky konfirmim anulohet. Kështu që, hapja e procedurës së ndarjes, është rruga më e shpejtë, për ta kthjelluar situatën, për sa u përket kontributeve për jetesë, përcaktimit të banesës dhe kujdestarisë për fëmijët. Një shkurorëzim kundër vullnetit të bashkëshortit, lejohet vetëm pas skadimit të afatit dyvjeçar të ndarjes. Në rastin kur vazhdimi i martesës është i papranueshëm, mund të ngrihet padi për shkurorëzim nga njëra palë, por kjo është e vështirë

të arrihet. Nëse arsytet për t'u shkurorezuar kundërshtohen, kjo procedurë mund të zgjasë shumë kohë. Informohuni në një zyrë këshilluese, te një avokate ose në gjykatë.

Ç'MUND TË BËJ, NËSE KAM QENË E DETYRUAR TË MARTOHEM KUNDËR VULLNETIT TIM?

Zgjedhja e lirë e bashkëshortit/bashkëshortes është një e drejtë, që vlen për të gjithë njerëzit, të cilët jetojnë në Zvicër. Ligji zviceran i ndalon martesat, që janë lidhur me detyrim, pa marrë parasysh nëse janë lidhur jashtë vendit apo në Zvicër. Kontaktoni www.zwangsheirat.ch ose zyrën tonë. Do të këshilloheni dhe do të shoqëroheni falas, në gjuhë të ndryshme.

SI DUHET TË VEPROJ, NËSE DUA TA ZGJIDH BASHKËJETESËN E REGJISTRUAR?

Çiftet me të njëjtën gjini mund të regjistrohen, duke themeluar kështu një bashkëjetesë me të drejta dhe detyra reciproke, të përngjashme me martesën. Nëse pësoni dhunë ose kërcënim nga partnerja juaj, policia mund të ushtrojë masa mbrojtëse kundër dhunës, në përputhje me ligjin, për mbrojtjen tuaj, dhe ju mund të hapni pranë gjykatës një procedurë për t'u ndarë ([broshurë për masa mbrojtëse ndaj dhunës](#)). Gjykata e rrethit, në vendbanimin tuaj, përgjigjet për këtë. Gjatë kësaj procedure rregullohen të njëjtat pika si në procedurën e shkurorezimit. Nëse nuk arrini të bini dakord me partneren tuaj, atëherë afati kohor i ndarjes, para zgjidhjes së partneritetit të regjistruar, është i përcaktuar një vit (në martesë është dy vjet). ([fletëpalosje për zgjidhjen e bashkëjetesës së regjistruar](#))

NE BASHKËJETOJMË PA LIDHJE LIGJORE (KONKUBINAT) DHE UNË DUA TË NDAHET

Bashkëjetesa nuk është formë jetese, që ka lidhje ligjore të detyrueshme. E rëndësishme është të dini se, në rastin e zgjidhjes së një bashkëjetese, zhvillohen disa procedura ligjore të ndryshme: Në rast se ekzistojnë fëmijë të përbash-

kët, zhvillohet procedura për përcaktimin e kujdestarisë dhe të së drejtës së përkujdesjes, tek Zyra Mbrojtëse e Fëmijëve dhe e të Rriturve ([kesb Zürich](#)). Përcaktimin e kontributit për jetesën e fëmijëve e bën gjykata e rrethit të vendbanimit ([Gjykata e Rrethit të Kanton Zürich](#)). Personi, i cili e merr përsipër kryesisht përkujdesjen e fëmijëve, pas zgjidhjes së bashkëjetesës, nuk ka të drejtë për kontribute për jetesë. Kush ka të drejtë të qëndrojë në banesë, varet nga kontrata e qirasë dhe nga bashkëpunimi i qiradhënësit dhe i ish-partnerit. Meqenëse, në rastin e ndarjes së bashkëjetesës, situata ligjore është e ndërlikuar, këshillohet marrja e këshillave tek një zyrë këshilluese ose tek një avokate. Nëse partneri, me të cilin bashkëjetoni, ushtron dhunë ndaj jush apo ndaj fëmijëve, ose nëse ju kërcënon mund të përfitoni edhe ju prej masave mbrojtëse, mbi bazën e Ligjit për Mbrojtje ndaj Dhunës ([broshurë për masa mbrojtëse ndaj dhunës](#)).

ADRESA TË RËNDËSISHME:

Hapja e procedurës së ndarjes ligjore
www.gerichte-zh.ch
formulari i procedurës ligjore të ndarjes

Dëftesa mjekësore në raste urgjente:
www.permanence.ch
Tel. 044 215 44 44

Avokatet/Shoqata e Avokatëve (Anwaltsverband):
www.zav.ch
www.anwaltskollektiv.ch
www.djs-jds.ch

Mbrojtje:
Numri urgjent i policisë **117**
Strehimore për gra: www.frauenhaus-schweiz.ch

Këshillimoret e Asistencës së Viktimave:
www.bif-frauenberatung.ch
www.frauennottelefon.ch
www.frauenberatung.ch

Përkrahje për fëmijët:
www.kokon-zh.ch

BIF IMPRESSUM

© Redaktim: BIF Beratungsstelle für Frauen
gegen Gewalt in Ehe und Partnerschaft
Postfach 9664, 8036 Zürich
Tel. 044 278 99 99
info@bif.ch
www.bif-frauenberatung.ch
PC 87-137016-4

IBAN: CH32 0900 0000 8713 7016 4

Korrigjimi: Karin Ernst
Këshillë ligjore: Brigit Rösli
Krijimi: artischock.net
Përktimi: Franziska Neziri, weiss traductions genossenschaft